

MARRËVESHJE E PËRGJITHSHME ADMINISTRATIVE
PËR ZBATIMIN E MARRËVESHJES PËR MBROJTJEN SHOQËRORE

ndërmjet

QEVERISË SË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

dhe

QEVERISË SË REPUBLIKËS SË TURQISË

98

**MARRËVESHJE E PËRGJITHSHME ADMINISTRATIVE
PËR ZBATIMIN E MARRËVESHJES PËR MBROJTJEN SHOQËRORE**

ndërmjet

QEVERISË SË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

dhe

QEVERISË SË REPUBLIKËS SË TURQISË

Sipas Nenit 21 të Marrëveshjes për Mbrojtjen Shoqërore ndërmjet Qeverisë së Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Turqisë, Autoritetet Kompetente të të dyja Palëve Kontraktuese kanë rënë dakord për dispozitat e mëposhtme në lidhje me zbatimin e Marrëveshjes.

**PJESA I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME**

**Neni 1
Përkufizime**

Të gjitha shprehjet që përdoren në këtë Marrëveshje kanë të njëjtin kuptim si edhe në Nenin 1 të Marrëveshjes për Mbrojtjen Shoqërore.

**Neni 2
Zyrat Ndërlidhëse përgjegjëse për zbatimin e legjislacionit të
përmendur në Marrëveshje.**

Zyrat Ndërlidhëse përgjegjëse për zbatimin e legjislacionit të përmendur në Nenin 2 të Marrëveshjes janë si më poshtë:

1. lidhur me Republikën e Turqisë;

1.1. Drejtoria e Përgjithshme e Institucionit të Sigurimeve Shoqërore, Ankara, e cila zbaton Ligjin e Sigurimeve Shoqërore që mbulon punëtorët e kontraktuar, Ligjin e Sigurimeve Shoqërore për punëtorët e kontraktuar të bujqësisë dhe legjislacionin që lidhet me Fondin e Pensioneve, siç është dhënë në Nenin provizor 20 të Ligjit të Sigurimeve Shoqërore Nr. 506.

1.2. Drejtoria e Përgjithshme e Fondit të Pensioneve të Nëpunësve të Shtetit, Ankara, e cila zbaton ligjin e Fondit të Pensioneve që mbulon nëpunësit shtetërorë.

1.3. Drejtoria e Përgjithshme e Institucionit të Sigurimeve Shoqërore të Marinarëve, Zanatçinjve dhe të Vetë-Punësuarve të tjerë (BAG-KUR), Ankara, në lidhje me zbatimin e Ligjit të Institucionit të Sigurimeve Shoqërore për Marinarët, Zanatçinjtë dhe të Vetë-Punësuarit e tjerë, dhe të Ligjit të Sigurimeve Shoqërore për personat e vetë-punësuar që punojnë në bujqësi.

2. lidhur me Republikën e Shqipërisë.

2.1. Instituti i Sigurimeve Shoqërore, i cili zbaton legjislacionin e Sigurimeve Shoqërore (sëmundje, barrëlindje, aksidente në punë dhe sëmundje profesionale, pensione pleqërie, invaliditeti dhe familjar) që mbulon personat e punësuar, punëdhënësit dhe të vetë-punësuarit.

2.2. Instituti i Sigurimit të Kujdesit Shëndetsor, i ngarkuar me zbatimin e legjislacionit të sigurimit të kujdesit shëndetsor.

3. Zyrat Ndërlidhëse janë të autorizuar të marrin të gjitha masat e nevojshme për të lehtësuar zbatimin e Marrëveshjes dhe në veçanti, të japin asistencë administrative dhe të ndërmjetsojnë në këtë çështje, në vazhdim të detyrave të dhëna në këtë Marrëveshje.

4. Zyrat Ndërlidhëse do të lëshojnë formularët e kërkuar për zbatimin e Marrëveshjes për Mbrojtjen Shoqërore dhe të kësaj Marrëveshje.

Neni 3

Përfitimet e përcaktuara në Nenin 5 të Marrëveshjes, i paguhet në mënyrë të drejtëpërdrejtë personave të treguar në Nenin 3 të Marrëveshjes.

PJESA II DISPOZITA LIDHUR ME LEGJISLACIONIN E ZBATUESHËM

Neni 4

1. Një person i siguruar do t'i paraqesë Institucionit të Palës Kontraktuese formularët që dëshmojnë legjislacionin e zbatueshëm të vendit të banimit, siç është theksuar në Nenin 6, paragrafi 1.2 të Marrëveshjes, dhe legjislacionin e vendit të origjinës, siç është theksuar në paragrafin 2 të të njëjtit Nen.

2. Këta formularë do të lëshohen

Në Republikën e Turqisë nga Zyra Ndërlidhëse përgjegjëse për zbatimin e legjislacionit, ku personi ish regjistruar si i siguruar së fundi.

Në Republikën e Shqipërisë nga Zyra Ndërlidhëse përgjegjëse për zbatimin e legjislacionit që mbron personat e siguruar së fundi.

Neni 5

E drejta për të zgjedhur, e përmendur në Nenin 6, paragrafi 4 të Marrëveshjes, ushtrohet brenda tre muajve nga momenti i hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshje ose nga momenti kur personi në fjalë fillon punë.

Personi i siguruar njërën nga tre kopjet e formularëve që tregojnë zgjedhjen e tij do t'ja paraqesë punëdhënësit të tij dhe dy kopjet e tjera do t'ja paraqesë Institucionit Kompetent të vendit ku ai punon.

Ky Institucion do të dërgojë një kopje të konfirmuar tek Institucioni Kompetent i Palës Kontraktuese.

E drejta për të zgjedhur bëhet e vlefshme nga dita e parë e muajit pasardhës të muajit kur personi informoi për zgjedhjen e tij Institucionin Kompetent.

Kur personi i siguruar, përmendur në Nenin 6, paragrafi 4 të Marrëveshjes, nuk deklaron ndonjë zgjedhje, atëhere bëhet i zbatueshëm legjislacioni i palës ku vepron punëdhënësi.

PJESA III

DISPOZITA LIDHUR ME PËRFITIMET

SEKSIONI 1

BASHKIMI I PERIUDHAVE

Neni 6

Bashkimi i periudhave të sigurimit

Kur marrja, mbajtja ose rimarrja e të drejtës për një përfitim nën legjislacionin e njërës prej Palëve Kontraktuese kushtëzohet me plotësimin e periudhave të sigurimit, periudhat e sigurimit të plotësuara nën legjislacionin e Palës tjetër Kontraktuese, do të bashkohen, përveçse kur këto periudha nuk përputhen.

Kur personi në fjalë nuk fiton ndonjë të drejtë pas bashkimit të periudhave, periudhat e sigurimit të plotësuara nën legjislacionin e një vendi të tretë, i cili ka marrëveshje për sigurimet shoqërore me të dy Palët Kontraktuese, do të bashkohen gjithashtu.

Neni 7

Nëqoftëse shuma e përgjithshme e periudhave të sigurimit, të plotësuara nën legjislacionin e njërës Palë Kontraktuese, është më pak se një vit dhe nëqoftëse asnjë e drejtë përfitimi nuk është fituar bazuar vetëm në këto periudha, asnjë kërkesë për marrje përfitimi, e lidhur me këto periudha, nuk mund të bëhet në Institucionin Kompetent të Palës Kontraktuese në përputhje me këtë Marrëveshje. Sidoqoftë, Pala tjetër Kontraktuese do t'i marrë në konsideratë këto periudha gjatë përcaktimit të së drejtës për përfitim.

SEKSIONI 2

PËRFITIMET PËR SËMUNDJE DHE BARRËLINDJE

Neni 8

Bashkimi periudhave të sigurimit

Nëqoftëse personi i siguruar ka periudha sigurimi në përputhje me legjislacionet e të dy Palëve Kontraktuese, këto periudha do të bashkohen për qëllimin e marrjes, ruajtjes ose rimarrjes së të drejtës për përfitim, përveçse kur ato nuk përputhen.

Neni 9

Të përfituarit nga Përfitimet Shëndetsore

Në zbatim të Nenit 2, paragrafët 1 dhe 2 të Marrëveshjes, personat e siguruar duhet t'i dorëzojnë Institucionit Kompetent të Palës tjetër Kontraktuese formularët, të cilët tregojnë të drejtën e tyre për përfitime shëndetsore dhe që janë lëshuar nga Institucioni Kompetent i Palës Kontraktuese ku ata janë regjistruar.

Nëqoftëse personi i siguruar nuk është në gjendje t'i paraqesë këto formularë, atëherë Institucioni Kompetent i Palës Kontraktuese, ku personi është rezident i përkohshëm, do të kërkojë nga Institucioni Kompetent i Palës tjetër Kontraktuese t'i lëshojë dhe dërgojë këto formularë.

Për dhënien e përfitimeve shëndetsore anëtarëve të familjes të personit të siguruar që banon në territorin e Palës tjetër Kontraktuese, përmendur në Nenin 11, paragrafi 5 i Marrëveshjes, Institucioni Kompetent i Palës Kontraktuese ku është regjistruar personi i siguruar, do të lëshojë formularët dhe dërgojë ato tek Institucioni Kompetent i Palës tjetër Kontraktuese.

Nëqoftëse sigurimi shëndetsor skadon, Institucioni Kompetent i autorizuar informon për këtë çështje Institucionin Kompetent të palës Kontraktuese me anë të një formulari. Në atë rast, e drejta për të përfituar nga asistenca skadon pas 30 ditësh nga data e lëshimit të formularëve të përgatitur nga Institucioni Kompetent.

Neni 10

Për dhënien e përfitimeve shëndetsore pensionistëve dhe anëtarëve të familjeve të tyre, sipas Nenit 12, paragrafi 2 të Marrëveshjes, Institucioni Kompetent përgjegjës për pagesën e pensioneve, do të lëshojë dhe dërgojë një formular në Institucionin Kompetent të Palës Kontraktuese të vend qëndrimit kryesor.

Nëqoftëse e drejta për përfitim skadon, Institucioni Kompetent do të informojë për këtë rast Institucionin Kompetent të Palës Kontraktuese me anë të një formulari standard. Në këtë rast e drejta për përfitim do të skadojë 30 ditë pas datës së lëshimit të këtij formulari, ose në ditën e vdekjes.

Nëqoftëse kushtet e pensionistëve dhe anëtarëve të familjeve të tyre, që marrin pensione të dhëna sipas legjislacionit të të dy Palëve Kontraktuese, kërkojnë një trajtim mjekësor urgjent gjatë qëndrimit të tyre të përkohshëm në territorin e një Pale Kontraktuese, ata do të dorëzojnë formularin e nevojshëm të lëshuar nga Institucioni Kompetent i vendit të qëndrimit të përkohshëm.

Neni 11

1. Lista e përfitimeve kryesore shëndetsore, përmendur në Nenin 13, paragrafi 1 të Marrëveshjes, paraqitet tek Aneksi 1 i kësaj Marrëveshje.

2. Pagesat e përfitimeve në para, që do të rimbursohen në përputhje me Nenin 13 dhe Nenin 8, paragrafi 4 të Marrëveshjes nga ana e Institucionit debitor, do t'i bëhet drejtëpërdrejtë përfituesit. Pagesat realizohen nëpërmjet urdhër-pagesave postare ose bankare, sipas kushteve të vendosura nga legjislacioni i Palëve Kontraktuese.

Neni 12

Rimbursimi i Kostove për Përfitimet Shëndetsore

1. Faturat e shpenzimeve të përfitimeve shëndetsore që do të rimbursohen në vlerat aktuale sipas Nenit 11, paragrafët 1 dhe 2 dhe Neneve 12, 13, 15, 18, 19, 20 të Marrëveshjes, i dërgohen Institucionit Kompetent të Palës Kontraktuese në formën e një shtese ndaj një materiali përmbledhës, që përgatitet bashkarisht çdo gjashtë

muaj. Ky Institucion do të rimbursojë shumën totale brenda tre muajve nga data e marrjes dhe miratimit të këtyre dokumentave.

2. Mbyllja e llogarive midis njëri tjetrit, që bëhet sipas Nenit 11, paragrafi 5 i Marrëveshjes, realizohet brenda të njëjtit vit kalendarik nëpërmjet pagesës së një shume të vetme.

Totali i kësaj shume përfitohet nga shumëzimi i kostos mesatare vjetore për familje me numrin e familjeve të përfshira në llogaritje. Komponentët e llogaritjes përcaktohen si më poshtë.

Kostoja mesatare mujore për person do të përcaktohet nëpërmjet pjestimit të shumës së përgjithshme të shpenzimeve shëndetsore të ndodhura gjatë një viti kalendarik për personin e siguruar dhe anëtarët e familjes së tij, me numrin e përgjithshëm të personave që kanë marrë shërbime të kujdesit shëndetsor primar dhe trajtim në spitale, si edhe me 12.

Kostoja mesatare mujore për familje do të përcaktohet nëpërmjet shumëzimit të kostos mesatare mujore për person me një shifër një pikë më të madhe se një koeficient i dhënë.

Koeficienti në vetvetë, i cili tregon numrin mesatar të anëtarëve të familjes për çdo person të siguruar, do të fitohet nëpërmjet pjestimit të numrit të përgjithshëm të anëtarëve të familjes me numrin e përgjithshëm të personave të siguruar. Ky koeficient përcaktohet veçmas nga Institucionet Kompetente të Palëve mbi një bazë vjetore për qëllime llogaritje dhe projektimi, duke marrë në konsideratë statistikat përkatëse.

Koeficienti dhe statistikat përkatëse do t'i dërgohen Institucionit tjetër Kompetent për të marrë konfirmimin e tij. Çdo mosmarrëveshje në këtë çështje duhet të zgjidhet nga Autoritetet Kompetente të Palëve Kontraktuese.

3. Numri i familjeve dhe muajve që do të merren në konsideratë, do të shpallen në një dokument mujor. Dokumentat e kompletuar, së bashku me kopje të deklaratave për vitin kalendarik, do t'i dorëzohen Institucionit Kompetent të Palës kontraktuese brenda gjashtë muajve të parë të vitit në vazhdim. Ky Institucion do t'i kontrollojë dhe do të paguajë diferencën brenda tre muajve.

SEKSIONI 3

SHPENZIMET FUNERALE

Neni 13

Për tu kualifikuar dhe për t'i marrë shpenzimet funerale, përmendur në Nenin 16 të Marrëveshjes, përfituesit banues në Shqipëri të personave të siguruar të regjistruar në Turqi dhe përfituesit banues në Turqi të personave të siguruar të regjistruar në Shqipëri, do të bëjnë kërkesë ose drejtëpërdrejtë në Institucionin përgjegjës për pagesën e përfitimeve, ose nëpërmjet Institucionit Kompetent të Palës së vendit ku ata banojnë. Dokumentat që provojnë statusin dhe, kur është e nevojshme, formularët që tregojnë periudhën e sigurimit, i bashkëngjiten peticioneve ose formularëve.

Dokumentat që verifikojnë vdekjen dhe, po qe se duhet, formularët që dëshmojnë periudhat e sigurimit, do t'i bashkëngjiten kërkesës.

SEKSIONI 4

PËRFITIMET PËR INVALIDITET, PLEQËRI DHE VDEKJE

Neni 14

Pagesat e Përfitimeve

Përfitimet e përmendura në Nenin 17 të Marrëveshjes do të paguhen gjithashtu edhe në rastin kur personi në fjalë apo përfituesit e tij banojnë në territorin e Palës tjetër apo të një Pale të Tretë.

Pagesat do të bëhen nëpërmjet urdhër pagesave postare apo bankare ndërkombëtare sipas afateve të përcaktuara nga legjislacioni në zbatim.

SEKSIONI 5

AKSIDENTET NË PUNË DHE SËMUNDJET PROFESIONALE

Neni 15

Gjatë zbatimit të Nenit 18, paragrafi 2 të Marrëveshjes, me synim mbajtjen e së drejtës për përfitim nga sigurimi shëndetsor për shkak të aksidenteve në punë dhe sëmundjeve profesionale në vendin ku ata banojnë së fundi, personi i siguruar duhet të dorëzojë në Institucionin e këtij vendi formularët e plotësuar nga Institucioni ku ai është regjistruar, të cilët dëshmojnë që vazhdimësia e së drejtës për kujdes mjekësor është autorizuar nga ky Institucion.

Në rast se formularët nuk janë plotësuar në avancë, Institucioni ku personi i siguruar është regjistruar, do t'i plotësojë ato sipas kërkesës së Institucionit të vendit të ri të banimit.

Gjatë zbatimit të Nenit 18, paragrafi 3 të Marrëveshjes, kujdesi mjekësor do të jepet sipas formularëve të plotësuar nga Institucioni Kompetent ku është regjistruar personi i siguruar, sipas kërkesës së Institucionit Kompetent të vendit ku banon personi në fjalë.

SEKSIONI 6

KONTROLLET ADMINISTRATIVE DHE MJEKËSORE

Neni 16

Shpenzimet për kontrollet administrative dhe mjekësore, të bëra nga Institucionet e vendit të qëndrimit të përhershëm ose të banimit të përkohshëm në bazë të kërkesës të Institucionit Kompetent të secilës Palë, do të përballohen nga Institucioni që i kërkoi këto kontrolle.

PJESA IV DISPOZITA TË PËRZJERA

Neni 17

Paraqitja e Kërkesave, Deklaratave dhe Apelimeve

Një person i siguruar do të bëjë kërkesë për pension sipas Marrëveshjes ose, në rastin e vdekjes së tij, anëtarët e familjes do të bëjnë kërkesë tek Institucioni Kompetent i vendit të banimit në përputhje me kushtet e vendosura nga legjislacioni i zbatueshëm.

Një person i siguruar ose përfituesit e tij, të cilët banojnë në territorin e një Pale të tretë, do t'i dërgojnë kërkesat e tyre tek Institucioni Kompetent ku personi në fjalë ka qënë i regjistruar së fundi si i siguruar.

Bërësi i kërkesës do të japë informacion, aq sa kjo të jetë e mundur, lidhur me Institucionet e të dy Palëve ku ai ka qënë i regjistruar, mbi punëdhënësin apo punëdhënësit, si edhe për vendin ku ai punoi si i vetë-punësuar.

Institucioni Kompetent i vendit të banimit, pas marrjes së kësaj kërkesë, ja kalon atë Institucionit Kompetent të Palës Kontraktuese nëpërmjet një formulari, së bashku me formularët që dëshmojnë periudhat e sigurimit të plotësuar në atë vend.

Institucioni Kompetent i Palës Kontraktuese, me kërkesën e Institucionit Kompetent të Palës Kontraktuese ku banon personi në fjalë ose përfituesit e tij, do të dërgojë nëpërmjet një formulari informacionin lidhur me periudhat e sigurimit të plotësuar në atë vend, sa më shpejt që të jetë e mundur.

Institucionet Kompetente të të dy Palëve Kontraktuese do të informojnë njëri tjetrin rreth vendimeve të marra prej tyre për çdo rast.

Apelimet, sipas Nenit 25 të Marrëveshjes, mund të dërgohen ose drejtëpërdrejtë tek Institucioni përkatës, ose nëpërmjet Institucionit Kompetent të vendit të banimit.

ANEKSI 1

Përfitimet Shëndetsore Bazë

1 - Lista e përfitimeve shëndetsore bazë paraqitet si më poshtë:

- a) Kurat (Trajtimet speciale),
- b) Kujdesi dhe trajtimet mjekësore në një konvaleshencë, sanatorium apo cdo lloj spitali.
- c) Masa trainimi për riaftësim funksional apo kthim në punë.

2 - Kur gjatë zbatimit të Nenit 13, paragrafi 1 të Marrëveshjes, shtyrja e dhënies së përfitimeve shëndetsore bazë bëhet e pamundur pa rrezikuar jetën apo shëndetin e personit përkatës, Institucioni Kompetent i palës kontraktuese dërgon një raport mjekësor që justifikon gjëndjen e emergjencës, në vend të një kërkesë për leje për dhënien e përfitimeve të tilla.

PJESA V
DISPOZITA KALIMTARE DHE PËRFUNDIMTARE

Neni 18
Dispozita Kalimtare

Në zbatim të Nenit 28, paragrafi 3 të Marrëveshjes, çdo rast invaliditeti, pleqërie apo vdekjeje i ndodhur përpara hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshje, do të merret në konsideratë me qëllim përcaktimin e të drejtave, përveç pagesave me shuma fikse që lindin nga Marrëveshja. Sidoqoftë, pagesat për të drejtat e fituara do të bëhen të pagueshme që prej ditës së hyrjes në fuqi të Marrëveshjes në rastin kur kërkesa është bërë brenda dy vjetëve pas kësaj date, dhe prej ditës së parë të muajit në vazhdim, kur kërkesa është bërë pas skadimit së periudhës dy vjeçare.

Neni 19

Kjo Marrëveshje e Përgjithshme Administrative hyn në fuqi njëkohësisht me Marrëveshjen për Mbrojtjen Shoqërore dhe do të jetë e vlefshme së bashku me të.

Kjo Marrëveshje e Përgjithshme Administrative është bërë në Stamboll, më 10 Shtator 1998, në dy kopje në secilën nga gjuhët turqisht, shqip dhe anglisht, të cilat janë njëlloj të vlefshme. Në rastin e ndonjë paqartësie në interpretim, do të merret në konsideratë teksti në gjuhën angleze.

Në emër të Qeverisë së Republikës
së Shqipërisë


Ass. Prof. Dr. ANASTAS ANGJELI



MINISTËR I PUNËS DHE
ÇËSHTJEVE SOCIALE

Në emër të Qeverisë së Republikës
së Turqisë

Prof. Dr. NAMİ ÇAĞAN



MINISTËR I PUNËS DHE
SIGURIMIT SHOQËROR